

R E L A C I O N

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7874, DATË 17.11.1994, “PËR STATUSIN E VETERANIT TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji ka si qëllim të bëjë një shtesë në ligjin nr.7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar, duke përcaktuar ditën e përkujtimit dhe të nderimit të veteranit të LANÇ-it.

Nëpërmjet projektligjit synohet të arrihet që, me përcaktimin e ditës së veteranit të LANÇ-it, të vlerësohet në vazhdim sakrificat dhe kontributi i veteranëve në çlirimin e vendit nga pushtuesit nazifashistë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj ka karakter teknik dhe nuk lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave dhe as me dokumente të tjera politike.

Projektligji nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim e miratim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Statusi i veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar është rregulluar nëpërmjet ligjit nr.7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar.

Nëpërmjet këtij ligji dhe vendimit nr.190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr.7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës

Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar, është dhënë statusi “Veteran i LANÇ-it”, trajtimi financiar mujor për personin që gëzon statusin, si dhe janë dhënë disa të drejta e përfitime të veçanta.

Megjithatë, duke qenë se ligji nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar, është hartuar para 25 vjetësh, gjatë implementimit në praktikë të tij ka lindur nevoja për shtesa për përmirësimin e tij.

Nëpërmjet projektligjit do të përcaktohet dita e përkujtimit dhe e nderimit të veteranëve të LANÇ-it, për përkushtimin, sakrificën, angazhimin dhe kontributin e tyre në çlirimin e vendit nga pushtuesit nazifashistë. Në këtë datë përkujtimore, organizata e veteraneve, shoqëria civile, institucionet shtetërore, qendrore e vendore dhe organet e pushtetit vendor organizojnë aktivitete të ndryshme për nder të veteranëve të LANÇ-it, të cilët kanë spikatur me përkushtimin, angazhimin dhe sakrificën e tyre në LANÇ dhe ndërtimin e vendit pas lufte.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në përputhje të plotë me rendin juridik të brendshëm.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përcakton ditën e veteranit të LANÇ-it.

Konkretisht, propozohet të shtohet një paragraf në fund të nenit 7, të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar, me këtë përmbajtje:

“Dita e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar është data 20 korrik.”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Me zbatimin e këtij projektligji do të ngarkohen institucionet shtetërore qendrore dhe organet e pushtetit vendor.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE